



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË

V E N D I M

Nr. 54, datë 09/12/2004

**“MBI DISA NDRYSHIME
NË BUXHETIN E NJËSIVE BASHKIAKE NR.2 DHE NR.11”**

Në mbështetje të ligjit Nr.8652, dt.31/07/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, neni 32/dh, ligjit Nr.8654, dt.31/07/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Bashkisë së Tiranës”, neni 6, pika 2 dhe 4, dhe neni 8, gërma “ç”, ligjit Nr.7776, dt.22/12/1993 “Për buxhetin lokal”, neni 18, ndryshuar me ligjin Nr.8399, dt.09/09/1998, Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.16, dt.10/03/2004 “Për miratimin e realizimit të buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2003 dhe detajimin e buxhetit të vitit 2004”, me propozimin e Kryetarit të Bashkisë së Tiranës, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I;

1. Të miratojë ndryshimin e destinacionit të fondit “Rikonstruksion zyrash” nga të ardhurat e Bashkisë së Tiranës, për Njësinë Bashkiake Nr.11 në fond për investime “Rikonstruksione rrugësh dhe infrastrukturës” që kapin shumën **878.897** lekë, sipas këtyre objekteve:

“Pastrim i kanalit të ujrave të zeza në anë të Fabrikës së Tullave” – Kodër Kamëz në shumën **217.401** lekë

“Rikonstruksion i K.U.Z afër Fabrikës së Tullave” - Kodër Kamëz në shumën **75.549** lekë

“Rikonstruksion i ish-kanalit vaditës në kufi me Paskuqanin” - Kodër Kamëz në shumën **294.467** lekë

“Rikonstruksion i rrugës që lidh rrugën “Lord Bajron” me hekurudhën” – Laprakë në shumën **291.480** lekë

2. Të miratojë një shtesë në buxhetin e Njësisë Bashkiake Nr.2, në shumën prej **2.400.000** lekësh, në zërin investime për “Realizimin e projekteve me Fondin e Zhvillimit Shqiptar” sipas këtyre objekteve:
 - Rruga “3 Vëllezërit Kondi” në shumën prej **1.100.000** lekë
 - Rruga “Mihal Grameno” në shumën prej **1.300.000** lekë
3. Efektet financiare të pikës 2 të këtij Vendimi të përballohen duke pakësuar në shumën **2.400.000** lekë, objektin “Ngritje ofiçine” nga të ardhurat e Bashkisë së Tiranës për vitin 2004.

4. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike, Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike, Njësitë Bashkiake Nr.2 dhe Nr.11.
5. Ky Vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

K R Y E T A R I

LUAN SHAHOLLARI